



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 069

Prishtinë, më 15 maj 2009

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 15 MAJ 2009

Seancën e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim GASHI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 99 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Shqyrtimi i Propozimit për zgjedhjen gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari i informoi deputetët me Propozimin për zgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 13 maj 2009, është pajtuar që votimi të jetë në mënyrë elektronike mbi bazën e listave të propozuara nga grupet parlamentare.

Ai njoftoi deputetët me procedurat e votimit për kandidatët e propozuar për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetari ftoi shefat e grupeve parlamentare që t'i propozojnë listat me kandidate për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja** i propozoi këta kandidatë:

1. Enver Hasani,
2. Gjyljeta Mushkolaj,
3. Ilirana Islami,
4. Kadri Kryeziu.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, përkrahu listën e propozuar nga GP i PDK-së.

Në emër të GP të AKR-së, deputetja **Rita Hajzeraj**, propozoi këta kandidatë:

1. Rizah Smaka,
2. Enver Hasani,
3. Gjylejta Mushkolaj,
4. Fejzullah Berisha.

Kryetari i GP të AAK-së, **Ardian Gjini**, përkrahu listën e propozuar nga GP i PDK-së.

Kryetari i GP të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, propozoi këta kandidatë:

1. Enver Hasani,
2. Halit Muharremi
3. Gjyljeta Mushkolaj,
4. Ilirana Islami.

Kryetarja e GP “7+”, Myfera Shinik, nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe serbe propozoi këtë kandidat:

1. Altay Suroi.

Kryetari i GP të SLS, Bojan Stojanoviq, nga radha e komunitetit serb propozoi kandidatin:

1. Ivan Čukaloviq.

Kryetari i GP “Zajedno”, Sllavisha Petrovqi, tha se mbështet propozimet e dhëna më lart.

Pas propozimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryetari hodhi në votim propozimin e GP të SLS-së, për të cilin duhej të votonin vetëm deputetët nga radha e komuniteteve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për22
Kundër..... 0,
Abstenime..... 0.

Pastaj, Kryetari hodhi në votim propozimin e GP “7+”, për të cilin duhej të votonin vetëm deputetët nga radha e komuniteteve . Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për17,
Kundër..... 5,
Abstenime..... 0.

Kryetari hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare të komuniteteve jo shumicë për të cilat duhej të votonin të gjithë deputetët e Kuvendit, të pranishëm në seancë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për71
Kundër..... 3,
Abstenime..... 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, zgjodhi dy kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese nga komunitetet jo shumicë:

1. Altay Surroi,
2. Ivan Čukalović.

Pastaj, Kryetari hodhi në votim kandidatët e propozuar nga GP i PDK-së, i përkrahur nga GP të LDK-së dhe i AAK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për76
Kundër..... 6,
Abstenime..... 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

I. Gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, zgjedhen:

1. Enver Hasani,
2. Gjyljeta Mushkolaj,
3. Ilirana Islami,
4. Kadri Kryeziu,
5. Ivan Čukalović dhe
6. Altay Suroy.

II. Vendimi i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për emërim dhe për dhënien e betimit para Presidentit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**